

Titulli/Grada: Prof i Asoc.
Emër Mbiemër: Mihallaq Qirjo

I punësuar me kohë të plotë si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Biologjisë, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 33 vjeçare si pedagog në lëndët e Ekologjisë dhe Ekologjisë së Ekosistemeve. Gjithashtu, drejton kurset e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm në disa Programe Studimi Master të Mësuesisë.

Pas diplomimit në UT në vitin 1990, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me fushat e kërkimit shkencor të Ekologjisë së Aplikuar për ekosistemet natyrore, dinamikën e popullatave dhe biodiversitetin.

Ka mbrojtur titullin akademik Profesor i Asociuar në vitin 2004. Ka mbi 35 artikuj dhe referime shkencore si rezultat i punës kërkimore shkencore në fushën e ekologjisë, mjedisit dhe edukimit mjedisor. Ka dhënë kontribut si autor për hartimin e teksteve mësimore si Etologjia (2002), dhe bashkëautor në Paketa e Gjelbërt (2006), Paketa e Ajrit (2015), Paketa e Gjelbërt Junior (2018).

Drejtuës dhe kontribues në shumë programe kombëtare dhe rajonale për zhvillimin e politikave të menaxhimit mjedisor në fushën e menaxhimit të mbetjeve, burimeve ujore, biodiversitetit dhe ndryshimeve klimatike. Aktualisht drejton dy programe kërkimore të UT lidhur me ndotjen nga mikroplastika në zonat lagunore të vendit (program kombëtar kërkimi financiar nga AKKSHI, 2021-2023) dhe Komunikimin Mjedisor (program ndërkombëtar financiar nga Programi Erasmus, 2021-2024).

Ka shërbyer në pozicione drejtuese të UT si Kryetar i Komisionit të Apelimit (2014-2020), anëtar i Këshillit të Etikës prej vitit 2020. Ka drejtuar Zyrën përfaqësuese për Shqipërinë të Qendrës Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (1994-2018) dhe mbajtur pozicionin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Budapest, Hungari në periudhën 2016-2017.